



576
6.2.23

**OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I TREGUT
DEPARTAMENTI LIGJOR DHE CESHTJEVE KORPORATIVE**

Nr. 756 prot.

Tiranë, më 03/02/2023

Lënda: Kërkesë në lidhje me intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues, dhe nominimeve të transaksioneve tregtare.

ENTIT RREGULLATOR TE ENERGJISE ✓

Bvd. "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimi", nr. 1023, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Në vijim të komunikimeve të deritanishme dhe në zbatim me Vendimin e ERE Nr.246, datë 29.09.2022, pika 2, si vijon "Periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore deri më 31 Mars 2023".

Ju bëjmë me dije se, OST sh.a në zbatim të vendimit të sipërpërmendor ka informuar në mënyrë periodike implementimin e ndryshimeve në platformën e Menaxhimit të Tregut.

Sikurse jeni vënë në dijeni nga raportet periodike, OST sh.a ka implementuar në platformën e Menaxhimit të Tregut intervalin 15 minuta në proceset e skedulimeve dhe tregut balancues, ku janë kryer dhe testime në mjedisin test të platformës.

Përsa më sipër pavarësisht implementimit në platformën e menaxhimit të tregut të intervalit kohor konform rregullave në fuqi, vlerësojmë se në kushtet ku menaxhimi i flukseve të energjisë si transaksionet me gjithë sistemet elektroenergitike fqinje, rakordimet me qendrën koordinative Swissgrid si dhe alokimet e kapaciteteve nga zyra e Koordinimit të Ankandeve në Europën Juglindore janë me bazë orare, OST nuk mund të operojë me rezolucion 15 minuta pasi do përballemi në kushtet e krijimit të disbalancave si rrjedhojë e mos rakordimeve të sipërcituara. Gjithashtu kooperimi i platformës së menaxhimit të tregut me platformen e Bursës Shqiptare të Energjisë është me rezolucion orar, sikurse citohet dhe në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes) të miratuara

me Vendimin Nr. 347, Datë 27.12.2022, Bursa Shqiptare e Energjisë do fillojë operimin me bazë orare.

Tashmë jemi njohur dhe me praktika nga vendet e rajonit dhe më gjërë që kanë tentuar të aplikojnë implementimin me rezolucion 15 minuta në proceset e skedulimeve, disbalancave dhe tregut balancues, të cilat nuk kanë rezultuar të suksesshme.

Për gjithë sa më sipër, OST vlerëson vijimin e operimit me bazë orare të llogaritjeve respektive të disbalancave, proceseve të tregut balancues dhe procesit të nominimit. Për këtë qëllim janë bërë dhe reflektimet përkatëse në draft propozimet e përmirësimeve të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit.

Në vijim të zhvillimeve rajonale, OST është e gatshme dhe ka infrastrukturën e nevojshme të asimilojë dhe të ecë me të njëjtin hap me vendet e rajonit përsa i përket tregut balancues.

Mbetemi të hapur për çdo sqarim të mëtejshëm, duke shpresuar se propozimi ynë do të merret në konsideratë prej jush.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I OST SH.A.


Skerdi Drenova

